



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 1 DHJETOR 2022, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
(Seanca filloi në orën 11:30)

Rendi i ditës:
Fjala përshëndetëse e Presidentit Federal të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier.

Lindita Nikolla – Sot në Kuvendin e Shqipërisë kemi një mik të madh dhe të nderuar, Presidentin Federal të Gjermanisë, Shkëlqesinë e tij, zotin Frank-Walter Steinmeier.

(Duartrokitje në sallë)

Zoti President, mirë se erdhët në Kuvendin e Shqipërisë!

Së bashku me Presidentin Federal janë sot në Kuvendin e Shqipërisë zoti Oliver Luksic, sekretar Parlamentar i Shtetit në Ministrinë për Çështjet Digjitale dhe Transportin, zoti Peter Beyer, zëvendëspresident i Shoqatës për Europën Juglindore në Bundestag, përfaqësuesja e qeverisë Federale, zonja Anna Lührmann, ministre e Shtetit për Europën dhe Klimën.

Mirë se erdhët në Kuvendin e Shqipërisë!

(Duartrokitje në sallë)

Vizita e Presidentit Steinmeier është një ngjarje e rëndësishme jo vetëm për vendin tonë,

por edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe perspektivën tonë të përbashkët europiane. Presidenti është një personalitet i shquar, politikan dhe diplomat i spikatur. Prej vitit 2017, në detyrën e tij të lartë si President Federal i Gjermanisë, vendit mik dhe partner të Shqipërisë, zoti Steinmeier ka dhënë një kontribut të njohur e të çmuar për Gjermaninë, Bashkimin Europian, Ballkanin Perëndimor dhe për paqen dhe sigurinë në botën e sotme të trazuar.

Presidenti Steinmeier është një ndër protagonistët kryesorë të kontributit të Gjermanisë për zhvillimin, mirëqenien dhe stabilitetin në kontinentin europian dhe në botë, një nxitës dhe mbështetës i integritit europian të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ne shqiptarët i jemi mirënjohës Gjermanisë për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e shkëlqyer politik dypalësh, për mbështetjen e fuqishme dhe të vazhdueshme ndaj zhvillimit të reformave dhe të demokratizimit të Shqipërisë, për kontributin si lokomotiva ekonomike dhe politike e Europës në zhvillimin dhe mirëqenien e popujve të kontinentit dhe të botës, për rolin e dallueshëm dhe qëndrimet e qarta për prosperitetin dhe përshpejtimin e rrugëtimit europian të Shqipërisë dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për Procesin e Berlinit dhe nismat e tjera nxitëse, për partneritetin e ngushtë në NATO në mbrojtje të paqes, të sigurisë dhe të stabilitetit, për qëndrimin e fortë, të qartë dhe të vazhdueshëm të Gjermanisë, për njohjen dhe mbështetjen e pavarësisë së Kosovës dhe të ardhmes së saj euroatlantike, për përkushtimin, kontributin, partneritetin dhe bashkëpunimin kundër ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, sulmeve kibernetike dhe agresioneve pushtuese në mbrojtje të sovranitetit, të integritetit dhe të lirisë së popujve e të kombeve, për kushtet e krijuara për integrimin e emigrantëve shqiptarë në Gjermani gjatë 3 dekadave të fundit dhe për mbështetjen e solidaritetin ndaj emigrantëve, refugjatëve dhe njerëzve të zhvendosur nga luftërat, krizat apo mungesat e stabilitetit në vendet dhe rajonet e tyre, për rolin e Gjermanisë, si vendi i njerëzve të punës, zhvillimit, progresit, solidaritetit dhe paqes!

Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni t'ia jap fjalën Presidentit Federal të Gjermanisë, Shkëlqesisë së Tij, zotit Frank-Walter Steinmeier.

I nderuar zoti President, fjala për ju!

Frank-Walter Steinmeier – Zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj, anëtarë të parlamentit,

Të nderuar anëtarë të qeverisë,

Shkëlqesi,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Është kënaqësi të jem sot pranë jush në Shqipëri, në Tiranë, në këtë qytet rinor, entuziast për të ardhmen dinamike, në këtë qytet vërtet europian. Tirana është qendra politike e Shqipërisë, ku gjallon demokracia europiane; është kryeqyteti europian i rinisë 2022. Çfarë do t'i shkonte më shumë se ky titull tani që, me çeljen e bisedimeve të anëtarësimit drejt BE-së, nis një fazë e re dhe e ardhmja e Shqipërisë në Europë është duke u konkretizuar?

Vizitën e fundit, me një funksion tjetër politik, e kam bërë para 6 vjetëve. Tani, pas më shumë se 2 vjetëve pandemi, kur bota është tjetër në shumë drejtime, jam serish këtu për vizitë në vendit tuaj, i cili prej shumë kohësh i përkushtohet Europës në mënyrë pothuajse empatike. Qëndrimin tuaj të qartë proeuropian e kam vëzhguar përmes kontakteve të shumta me përfaqësues të politikës së brendshme, po ashtu edhe gjatë periudhës sime të presidencës, për të cilin kam ndierë shumë gëzim këto kohë, ku gjetkë në Europë bëhet një politikë skeptike ndaj BE-së.

Gëzohem që jam pranë jush, pranë miqve europianë, dhe mund ta përjetoj në vetë të parë atmosferën e vendit tuaj të mrekullueshëm! Shumë faleminderit që më ftuat për të vizituar Shqipërinë! Për mua është një nder vërtet i madh që mund të flas në këtë parlament!

Gjermania dhe Shqipëria janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën prej dekadash, bashkëpunimi ynë daton prej vitit 1988 dhe vendi im e shoqëron rrugëtimit tuaj drejt Europës që prej asaj kohe, gjë që ju e dini. E kemi mbështetur vendin tuaj kur u çliruat nga izolimi i diktaturës staliniste të Hoxhës dhe ju mbështesim në ndërtimin ekonomik të vendit tuaj.

Marrëdhëniet tona shfaqen në shumë aspekte të tjera. Më shumë se 70 mijë shqiptarë

jetonjë tashmë në Gjermani. Volumi tregtar midis Gjermanisë dhe Shqipërisë në vitin 2021 ka arritur vlerën e 450 milionë eurove. Vendi ynë është partneri tregtar i katërt më i madh për Shqipërinë. Sipërmarrjet gjermane, një prej të cilave do ta vizitoj gjatë qëndrimit tim këtu, janë aktive dhe angazhohen në vendin tuaj.

Edhe në dimensionin kulturor, zonja dhe zotërinj, ne bashkëpunojmë ngushtë me njëritjetrin. Në vitin 2019 ka hyrë në fuqi marrëveshja gjermano-shqiptare për bashkëpunimin kulturor; madje prej 15 vjetësh në Shqipëri organizohet “Tetori gjerman”. Pra, organizohen një shumësi aktiviteteve kulturore në mbarë vendin.

Po kështu shkëmbimet gjermano-shqiptare midis nxënësve dhe studentëve, si dhe marrëdhëniet e ngushta midis shkencëtarëve gjermanë dhe shqiptarë nuk janë vetëm një shenjë e miqësisë midis dy popujve tanë, por ato kanë sjellë edhe raporte miqësie midis njerëzve të veçantë. Është edhe një fushë tjetër, ku gjen shprehje lidhja jonë e ngushtë: miqësia në futboll. Lojtarët shqiptarë e kanë pasuruar gjithnjë bundesligën gjermane me aftësitë e tyre, këtu e kam fjalën për Altin Rakllin apo Mërgim Mavrajn, të njohur në Gjermani edhe sot e kësaj dite dhe, nga ana tjetër, trajneri gjerman Thomas Brdariç arriti të fitonte kupën para pak kohësh me klubin e Vllaznisë, duke e çuar atë në *Conference League*. Kjo tregon se edhe në fushën e sportit ne punojmë me shpirt skuadre me njëritjetrin.

Zonja dhe zotërinj,

Për t’u kthyer te politika, unë jam këtu pranë jush pak muaj pasi Bashkimi Europian nisi bisedimet e anëtarësimit me Shqipërinë. Data 19 korrik ishte një gur kilometrazhi në rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Shqipëria ka dorëzuar kërkesën për anëtarësim para 13 vjetësh dhe në vitin 2014 u bë vend kandidat. Pas 8 vjetësh të tjerë, më në fund, bisedimet nisën. Kam parë me gëzim se si shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë vendosur masa të reja në kuadër të procesit të Berlinit, që e kanë përmirësuar që tani jetën e të gjithë banorëve të rajonit, në mënyrë krejt praktike dhe konkrete. Së shpejti, do të mjaftojë vetëm paraqitja e dokumentit të identifikimit për të kapërcyer kufijtë në rajon; së shpejti do të jetë e mundur të nisët një marrëdhënie pune apo arsimimi në një shtet tjetër të Ballkanit Perëndimor; së shpejti do

të njihen diplomatet profesionale dhe arsimore në mënyrë reciproke dhe tregu i përbashkët rajonal do t’i çojë përpara ekonomisht të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Të gjitha këto do ta thjeshtojnë dhe do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve në vendin tuaj, dhe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Të nderuar zotërinj dhe zonja deputete,

Më entuziazmon fakti se sa shumë ndihet shpirti europian në vendin tuaj dhe dëshiroj t’u bëj një thirrje njerëzve që kanë dyshime për Bashkimin Europian, që, në njëfarë mënyre, e kanë humbur nga sytë dimensionin historik të projektit europian: ejani në Shqipëri dhe lejoni të “infektoheni” këtu sërish me shpirtin proeuropian!

Zonja dhe zotërinj,

Ju e keni zhvilluar dhe e keni reformuar vendin tuaj duke pasur në mendje objektivin e qartë të vazhdimit në Bashkimin Europian, dhe sukseset janë dukshëm të identifikueshme. Keni realizuar reforma administrative, tatimore; është ngritur një prokurori speciale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Aktualisht ka një reformë voluminoze në drejtësi, e cila, në këtë fazë që është, shërben si shembull për vendet e tjera, dhe të gjitha këto mund të bëhen vetëm atëherë kur e di se çfarë do.

Ju, shumë të nderuar zonja dhe zotërinj, dëshironi një të ardhme të mirë për Shqipërinë dhe jam i sigurt se vendi juaj do të jetë një partner mjaft i besueshëm për shtetet anëtare të BE-së.

Unë e di që rruga e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian do të vijojë të jetë ambicioze, ndaj, do t’ju lutesha sot që të vazhdoni të punoni më tej në luftën kundër pengesave aty ku ato ndodhen. Punoni më tej në sprapsjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, vijoni punën me reformën në drejtësi, të iniciuar tanimë dhe, para së gjithash, opozita dhe qeveria duhet të punojnë së bashku përtej llogoreve. Unë mendoj se kjo përpjekje ia vlen për destinacionin e përbashkët, që është anëtarësimi në BE. Ashtu sikundër deri tani, ju mund të keni besim në mbështetjen e mëtejshme të Gjermanisë në këtë rrugëtim.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Ju po përshkoni tanimë rrugën e procesit të anëtarësimit në kushte vërtet të vështira. Sulmi brutal i Rusisë kundër Ukrainës ka sjellë jo vetëm vdekje, vuajtje, shkatërrime të ukrainasve, por e ka zhytur të gjithë Europën në një krizë ekonomike dhe pasojat e kësaj lufte po ndihen në mbarë botën. Kësisoj, vendin tuaj, Shqipërinë, e ka goditur fort rritja e çmimit të energjisë, është rritur çmimi i karburanteve me më shumë se 50%, si dhe kriza ekonomike.

Të nderuar deputetë, unë e di që kjo është një tjetër goditje me të cilën duhet të përballeni, pas tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë së Covid-it, ndaj bëhet edhe më mbresëlënëse të shikosh se me sa këmbëngulje vendi juaj vazhdon të ndërmarrë përpjekjet që janë të nevojshme për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Unë shikoj se në Shqipëri nuk ka asnjë dyshim në orientimin e qartë drejt Bashkimit Europian dhe ankorimin e palëkundur në NATO. Qëndrueshmëria juaj, pozicionimi juaj në krah të vlerave tona europiane dhe transatlantike më emocionojnë dhe ju mund të jeni model për shumë njerëz kudo në Europë, madje edhe në vendin tim. Edhe pse anëtarësimi në Bashkimin Europian nuk është ende realitet, Shqipëria në nivel ndërkombëtar është provuar prej kohësh që ka një demokraci të pjekur. 30 vjet pas traumës historike të diktaturës, vendi juaj është sot një aktor i njohur në arenën ndërkombëtare dhe një mbrojtës i rendit botëror bazuar në rregulla, si anëtar i NATO-s dhe i OSBE-së dhe aktualisht një anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ju bashkëpunoni ngushtësisht me partnerët tuaj transatlantikë dhe europianë.

Pas luftës brutale dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare të Rusisë ndaj Ukrainës, Shqipëria u vendos qartësisht në krah të të sulmuarve, viktimave në skenën ndërkombëtare, u tregua solidare dhe pranoi refugjatë. Edhe për këtë dua të shpreh falënderimin tim të përzemërt!

Zonja dhe zotërinj,

Bashkimi Europian është një projekt unik historik, një aleancë shtetesh, të cilët qëndrojnë pranë njëri-tjetrit në përpjekje për prosperitet, në ruajtje të liberalitetit tonë, lirisë së lëvizjes, të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor si objektiva të barasvlershme me njëra-tjetrën.

Bashkimi Europian është përgjigjja historike ndaj rrënimin nationalist dhe

shovinizmit që kanë shkaktuar për shekuj në Europë, është përgjigjja edhe ndaj sfidave globale, sikundër është lufta ndaj ndryshimeve klimatike. Këto sfida, asnjë vend nuk mund t'i përballojë më i vetëm.

Ky model europian i bashkëpunimit, ku vlen forca e të drejtës dhe jo e drejta e më të fortit, ku bëhet fjalë për ndërveprim dhe bashkëpunim në të mirë të të gjithëve, vihet në pikëpyetje përmes luftës brutale të Rusisë ndaj Ukrainës.

Putini nisi një sulm në marrëzinë e tij imperialiste, në përpjekje për të vendosur me dhunë një shtet fqinj nën pushtetin e tij. Bashkimi Europian ka treguar të jetë i palëkundur përkundrejt sulmit rus, nuk ka lejuar të përçahet nga ky sulm, por përkundrazi është bashkuar si kurrë më parë.

Edhe shtetet e B20-s në Bali e bënë të qartë dhe u pozicionuan qartësisht kundër veprimeve brutale të Rusisë, si shkelje e të drejtës ndërkombëtare.

Shqipëria, që aktualisht mban një përgjegjësi të veçantë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dëshmoi të jetë një partner i vendosur i besueshëm. Kjo tregon se ne mund të mbështetemi te Shqipëria, ashtu siç vendi juaj mund të mbështetet te ne dhe te BE-ja.

Zonja dhe zotërinj,

Shqipëria ka qenë, në të shkuarën për një kohë të gjatë top lojërash për interesat imperialiste të perandorive agresive. Këtë politikë dhe këtë qëndrim në variantin e saj më të keq e përfaqëson vendi im gjatë epokës së tij më të errët. Ndaj, nisur pikërisht prej historisë së vendit tuaj, është emocionuese të shohësh tani se si një Shqipëri e lirë do t'i bashkohet me vullnetin e saj të lirë Europës së lirë, një unioni që premtton: lirinë, mirëqenien dhe sigurinë, në të njëjtën kohë e lejon Shqipërinë, sikundër të gjitha vendet e tjera anëtare, të ruajnë unikalitetin e tyre. Europa gëzohet për ardhjen e Shqipërisë.

Zonja dhe zotërinj, ju falënderoj për durimin tuaj në rrugëtimin drejt Europës dhe, ju lutem, të vazhdoni në këtë rrugë me këmbëngulje dhe durim të mëtejshëm, derisa ky rrugëtim të përmbillet me sukses: me pranimin në BE!

Kur vij në Shqipëri, e ndiej se zemra juaj rreh për Europën, zemra juaj jeton në mënyrë europiane. Kjo do t'ju ndihmojë t'i kapërceni

edhe ato pjesë të pengesave që i keni ende përpara vetes në rrugën drejt BE-së. Jam i sigurt për këtë. Siç thotë një shprehje e bukur shqiptare: “Kur ke zemër, ke edhe krahë”.

Përzemërsisht, faleminderit!

(Duartrokitje)

Lindita Nikolla – Ju faleminderit, zoti President, për fjalët tuaja të ngrohta dhe vlerësuese për Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe për rikonfirmimin e mbështetjes së Gjermanisë për zhvillimin, mirëqenien, demokratizimin dhe rugëtimin evropian të Shqipërisë!

Mesazhet dhe vlerësimet tuaja janë një inkurajim dhe inspirim për Kuvendin, qeverinë, institucionet e Shqipërisë dhe për të gjithë qytetarët shqiptarë. Bashkëpunimi, mbështetja dhe partneriteti me Gjermaninë mike është një garanci për konsolidimin e demokracisë, për përshtetimin e zhvillimit dhe të ardhmes europiane të Shqipërisë.

Zonja dhe zotërinj deputetë, lejomëni të përcjell Presidentin e Gjermanisë!

(Seanca u mbyll në orën 12:00)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Dokumentacionit
dhe Informacionit
Julia Done**